

URDHËR
Nr. 708, datë 9.12.2025

**PËR DISA SHFUQIZIME NË URDHËRIN NR. 619, DATË 16.10.2025, TË MINISTRIT
TË DREJTËSISË, “PËR AUTORIZIMIN DHE DELEGIMIN E DISA
KOMPETENCAVE/AUTORITETIT TË MINISTRIT TË DREJTËSISË,
ZËVENDËSMINISTRIT TË DREJTËSISË, znj. ELONA HOXHA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 619, datë 16.10.2025, të ministrit të Drejtësisë, “Për autorizimin dhe delegimin e disa kompetencave/autoritetit të ministrit të Drejtësisë, zëvendësministrit të Drejtësisë, znj. Elona Hoxha”, të ndryshuar, në pikën 6, bëhen shfuqizimet e mëposhtme:

a) në shkronjën “d”, togfjalëshi “institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë në fushën penale dhe civile” shfuqizohet;

b) shkronja “dh” shfuqizohet.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Elona Hoxha, për zbatimin këtij urdhri.

3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Besfort Lamallari